

#18 



Advocacy Center
for **Democratic Culture**

QERSHOR
2022

BULETINI



office@acdc-kosovo.org
ngoacdc@gmail.com

SOCIAL MEDIA



Cika Jovina 3, North Mitrovica
Prote Mateje 48, Belgrade
Fehmi Agani 168/5, Pristina

HYRJE

Buletini i edicionit të qershorit përmban lajmet më të fundit, ngjarjet dhe aktivitetet e kryera nga ACDC. Dy projektet janë përfunduar me sukses, praktika tre mujore për avokatë të rinj në Gjykatën Themelore në Mitrovicë ka përfunduar, gjithashtu u lansua edhe fushata mediatike për promovimin e diversitetit kulturor, ndërsa aktivitetet në rrugë nëpër Kosovë kanë vazhduar me rregull për të ofruar ndihmë juridike falas për qytetarët.

KONFERENCA PËRMBYLLËSE E PROJEKTIT "LEHTËSIMI I QASJES NË DREJTËSI DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË RAJONIN E MITROVICËS"



Konferenca për të drejtat e njeriut, shërbeu si ngjarje përfundimtare e projektit të mbështetur nga UNMIK-u "Lehtësimi i qasjes në drejtësi dhe promovimi i të drejtave të njeriut në rajonin e Mitrovicës", që u mbajt më 21 qershor, në ambientet e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë IBCM. Panelistë ishin z. Jerome Bouyjou, Shef i Sektorit për të Drejtat e Njeriut në UNMIK, znj. Marija Radulović, zëvendëse e Avokatit të Popullit të Kosovës dhe z. Lubisha Bashçareviq, nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë. Konferenca kishte për qëllim të theksonte rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut.

Në fjalën e tij hyrëse, Drejtor Ekzekutiv i OJQ ACDC z. Dushan Radaković, prezantoi rezultatet dhe arritjet e projektit, ndërsa panelistët prezantuan punën e institucioneve të tyre dhe diskutuan për të drejtat kombëtare dhe evropiane/ndërkombëtare të njeriut, standardet dhe aplikimi i tyre.



ARRITJA E PROJEKTIT

Përmes aktiviteteve të ndryshme, projekti i financuar nga UNMIK-u, "Lehtësimi i qasjes në drejtësi dhe promovimi i të drejtave të njeriut në rajonin e Mitrovicës" kishte për qëllim përmirësimin e kushteve të punës në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe ngritjen e kapaciteteve për promovimin e të drejtave të njeriut në rajonin e Mitrovicës.

Infografika ofron arritjet e projektit nga shtatori 2021 deri në qershor 2022.

TRAJNIMI ME ZYRTARËT KOMUNAL NGA VERIU I KOSOVËS

OJQ ACDC, në muajin qershor, organizoi trajnime me zyrtarët komunalë për të drejtat e njeriut/gjininë/mos-diskriminimin/komunitetet/kthimin, nga veriu i Kosovës, që u ofroi pjesëmarrësve mundësinë të mësojnë më shumë rreth koncepteve themelore të barazisë gjinore, standardeve ndërkombëtare dhe Ligjit për Barazinë Gjinore. Trajnimi u mbajt nga znj. Marija Radulović, Zëvendëse e Avokatit të Popullit.



"BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN - PERSONAT E PAGJETUR"

Konferenca "Ballafaqimi me të kaluarën - Personat e Pagjetur", u mbajt më 13 qershor në ambientet e OJQ ACDC. Panelistë ishin z. Negovan Mavriq dhe znj. Silvana Marinković, Koordinatorë të Shoqatës së Personave të Pagjetur, z. Aid Cerkini, Anëtar të Qendrës Burimore të Personave të Zhdukur, dhe znj. Ines Aljović Mihajloviq, Zyrtare e Programit në ACDC.



Konferenca kishte për qëllim të theksojë rëndësinë e adresimit të çështjes së personave të pagjetur në Kosovë dhe të prezantojë rezultatet e projektit "Ballafaqimi me të kaluarën dhe pajtimi në Kosovë përmes ndërgjegjësimit për çështjen e personave të pagjetur", realizuar nga OJQ ACDC.

BISEDA NË MEDIA

Radmila Petroviq, poete e re nga Serbia e cila po qëndronte në Prishtinë në kuadër të programit READ dhe Slobodan Masic, shkrimtar nga Kosova, folën për përvojat e tyre në promovimin e kulturës së leximit, sfidat, sukseset dhe bashkëpunimin rajonal.




Biseda mediatike është pjesë e projektit “Mbështetja e shkrimtarëve të rinj në dialogun ndërkulturor dhe promovimi i diversitetit kulturor” i realizuar nga OJQ ACDC dhe i mbështetur nga projekti i BE-së Rrjeti Rajonal për Diversitet Kulturor – READ, i zbatuar nga Instituti Goethe në Shkup, si partner kryesor dhe 5 organizata partnere nga rajoni. Qëllimi i projektit READ është të promovojë aftësitë e leximit ndërkulturor dhe vlerat demokratike përmes kulturës së leximit.



OP-ED

Erzen Isufi, mentor vullnetar, i certifikuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka shkruar OP-ED për promovimin e leximit. Në tekstin e tij, ai i'u referua kulturës së të lexuarit në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e motivimit të të rinjve për të lexuar si një nga faktorët vendimtar në rritjen e performancës së tyre mësimore dhe zhvillimin profesional.

FUSHATA MEDIALE PËR DIVERSITETIN KULTUROR

Në qershor, OJQ ACDC filloi një fushatë mediale, duke përfshirë qytetarët nga Kosova për të ndarë një mesazh mbi diversitetin kulturor. Lexoni mesazhet e Slobodan, Lulzim dhe Ilida. 



Fushata e mbështetur nga READ synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të promovojë mirëkuptimin dhe respektin për kulturat e ndryshme dhe shprehjet kulturore.

M4Y

Në qershor, komisioni për përzgjedhjen e granteve në kuadër të projektit “Komunat për Rini - M4Y”, u takua për të vlerësuar aplikacionet e pranuar dhe për të përzgjedhur projektet që do të zbatohen. Gjatë muajit të ardhshëm pritet nënshkrimi i kontratës dhe fillimi i zbatimit të projektit.

NDIHMË JURIDIKE FALAS PËR VIKTIMAT E DHUNËS

Në muajin qershor, në Zubin Potok dhe Graçanicë u organizuan aksione në rrugë - "Klinika Ligjore Mobile", me qëllim të ndërgjegjësimit të qytetarëve për problemet e dhunës me bazë gjinore dhe në familje, si dhe të ofrojë informata të nevojshme për përdorimin e ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës.

Projekti "Iniciativa për Edukim kundër Dhunës në Familje dhe Seksuale" zbatohet nga Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) në bashkëpunim me Institutin e Drejtësisë së Kosovës dhe OJQ ACDC.



Ky aktivitet njëditor do të vazhdojë edhe në komunat tjera të Kosovës me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e parandalimit dhe veprimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, me synim kryesor mbrojtjen e grave si grupi më i cenueshëm.



TAKIMI I KATËRT KOMUNAL

Më 27 qershor u mbajt takimi i katërt komunal në kuadër të projektit "Rritja e reagimit institucional ndaj korrupsionit në veri të Kosovës".

Panelistë ishin z. Visar Prebreza nga Kallxo.com, i cili po ashtu punon me BIRN Kosova, z. Zoran Gavrilović nga Byroja për Hulumtime Sociale - BIRODI nga Beogradi dhe znj. Jovana Filipović, juriste nga Graçanica, Kosovë.

Në takim u trajtua korrupsioni në Kosovë dhe rajon, me theks të veçantë korrupsioni në institucionet lokale dhe qendrore.



KSC SESION INFORMUES

Në bashkëpunim me OJQ ACDC, përfaqësuesit e Dhomave të Specializuara të Kosovës mbajtën sesionin informativ për të prezantuar punën dhe mandatin e DSK-së. Në sesionin informativ morën pjesë avokatë dhe qytetarë të tjerë të cilët patën mundësinë të njihen me punën e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit të KSK-së.



SIMULIMI I SEANCËS GJYQËSORE

Më 29 qershor, praktikantët e angazhuar në projektin "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitet me shumicë serbe", financuar nga INL, mbajtën simulimin e gjykimit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, duke i përfunduar praktikën tre mujore. Simulimi i séances gjyqësore është përgatitur me ndihmën e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Ky aktivitet u ofroi praktikantëve mundësinë për të demonstruar aftësitë dhe njohuritë që ata fituan në punën me gjyqtarët dhe stafin e gjykatës.



Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković foli për RTS-në rreth marrëveshjes energjetike dhe termocentralit "Vallaç".

